



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, duke vendosur sipas kërkesave për rishqyrtim të OE "Studio Hapsira Sh.P.K." të datës 06.03.2024, të OE "Infra Plus Sh.P.K." të datës 05.03.2024, të OE "Vizion Project" të dt. 06.03.2024, të OE "Geo Group Sh.P.K." të datës 05.03.2024 si dhe të "Arhiko.Ing Sh.P.K." të datës 05.03.2024, kundër njoftimit mbi vendimin të datës 01.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Studio Hapsira Sh.P.K." të datës 06.03.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.03.2024.**
- II. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Infra Plus Sh.P.K." të datës 05.03.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.03.2024.**
- III. MIRATOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Vizion Project" të dt. 06.03.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.03.2024.**
- IV. REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Geo Group Sh.P.K." të datës 05.03.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.03.2024.**
- V. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE "Arhiko.Ing Sh.P.K." të datës 05.03.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 01.03.2024.**
- VI. ANULOHEM njoftimi mbi vendimin i datës 01.03.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në RIVLERËSIM.**
- VII. NJOFTOHEN operatorët ekonomik parashtues si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Ndaj njoftimit mbi vendimin e datës 01.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, brenda afatit ligjor janë pranuar kërkesat për rishqyrtim të OE "Studio Hapsira Sh.P.K." të datës 06.03.2024, të OE "Infra Plus Sh.P.K." të datës 05.03.2024, të OE "Vizion Project" të dt. 06.03.2024, të OE "Geo Group Sh.P.K." të datës 05.03.2024 si dhe të OE "Arhiko.Ing Sh.P.K." të datës 05.03.2024.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesave për rishqyrtim të parashtguesve është gjetur se kërkesat janë të lejuara dhe janë parashtuar brenda afatit nga personat e autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar ato. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të këtyre kërkesave.

1. **Pretendimet e OE "Studio Hapsira Sh.P.K." janë se tenderuesi i rekomanduar për kontratë "Flori Jahaj" ka ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta ndërsa autoriteti kontraktues me rastin e përcaktimit të çmimit jonormalisht të ulët sipas shkresës standarde nuk ka marrë parasysh fare pagat e stafit të angazhuar për këtë projekt, koston e shpenzimeve të printimit, koston e tatimeve dhe benefitit si dhe koston e shpenzimeve operative.**

Fillimisht duhet sqaruar se për parashtguesin nuk është fare kontestues fakti se autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime nga tenderuesi i rekomanduar përmes letrës standarde për tenderët jonormalisht të ulët. Për parashtguesin mbetet kontestues vetëm fakti nëse vlerësimi i sqarimeve që ka ofruar tenderuesi i rekomanduar është bërë në përputhje me nenin 41 paragrafët 41.8 dhe 41.9 lidhur me paragrafin 41.10 të RRPP. Në këtë drejtim, tenderuesi i rekomanduar me datë 30.01.2024 ka dërguar sqarimet shtesë për tenderin jonormalisht të ulët mirëpo në raportin e vlerësimit nuk evidentohet askund se në cilën formë dhe mbi bazën e cilave kritere komisioni vlerësues ka përcaktuar tenderin jonormalisht të ulët sipas sqarimeve të ofruara nga tenderuesi i rekomanduar. Duke marrë parasysh këtë fakt duke cekur se përmes nenit 41 par. 41.10 të RRPP është përcaktuar se "Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose: a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët, brenda dy dite nga data e vendimit". Ndërsa përmes nenit 41 par. 41.8 RRPP është përcaktuar se "Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara". Tutje përmes nenit 41 par. 41.9 thuhet se "Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet".

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Studio Hapsira" Sh.P.K. janë të bazuara pjesërisht ndërsa kërkesa për rishqyrtim është miratuar pjesërisht.

2. **Pretendimet e OE "Infra Plus Sh.P.K." janë se oferta e tenderuesit të rekomanduar ka qenë pa validitet nga data 18.02.2024 deri me datë 26.02.2024.** Po ashtu pretendon se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar certifikatë mbi dënimet penale në emër të Veton Jahaj i cili nuk evidentohet si drejtor i kompanisë sipas certifikatës së biznesit të lëshuar nga ARBK por vetëm sipas një autorizimi të lëshuar nga pronarja e kompanisë.

Sa i përket validitetit të ofertës duhet sqaruar se tenderuesi i rekomanduar e ka vazhduar validitetin e ofertës në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktues dhe ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi si i tillë. Ndërsa sa i përket pjesës së pretendimeve ankimore lidhur me certifikatën penale, duhet cekur se në dokumentet e biznesit të tenderuesit të rekomanduar për kontratë z. Veton Jahaj nuk evidentohet si pronar aksionar apo drejtor menaxhues apo përfaqësues i autorizuar sipas ligjit. Lidhur me këtë çështje komisioni rivlerësues ka mundësinë që së paku të kërkoj sqarime shtesë nëse kjo do të jetë e nevojshme.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Infra Plus Sh.P.K." janë të bazuara pjesërisht ndërsa kërkesa për rishqyrtim është miratuar pjesërisht.

3. **Pretendimet e OE "Vizion Project" janë se tenderuesi i rekomanduar "Florije Jahaj" por edhe dy tenderuesit e tjerë të pasuksesshëm "Infra Plus" Sh.P.K. dhe "Arhiko.ing" Sh.P.K. kanë ndërhyrë në paramasë përkatësisht çmimet e ofruara në nënpozicionet përkatëse të paramasës nuk përputhet me çmimin total të pozicionit përkatës rrjedhimisht nuk përputhet as me çmimin total të poentuar.**

Nga administrimi i paramasave me të cilat kanë tenderuar operatorët ekonomik përkatës, është gjetur se Florie Jahaj dhe "Infra Plus" Sh.P.K. kanë ndërhyrë në paramasë dhe kanë devijime të cilat tejkalojnë 2% në pozicionin A, B, C dhe E. Ndërsa tenderuesi "Arhiko.ing" ka ndërhyrë në paramasë dhe ka devijime të cilat tejkalojnë 2% në pozicionin A, D, E dhe F.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Vizion Project" janë të bazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

4. **Pretendimet e OE "Geo Group Sh.P.K." manifestohen duke kundërshtuar arsyet për shkak të cilave parashtruesi është eliminuar si tenderues i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit, duke pretenduar se është plotësuar pjesa e parë pika 3 nënkriteri 1 dhe 2 i dosjes së tenderit si dhe bartësi i konzorciumit ka ofruar dëshmi të kënaqshme për qarkullim bankar në vlerë së paku 51% të shumës 300,000.00 euro gjatë 3 viteve të fundit para publikimit të njoftimit për kontratë.**

Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi ka dorëzuar si grup i operatorëve ekonomik së bashku me operatorin ekonomik "Illyrian Consulting Engineers Sh.P.K." Përmes nenit 26 par. 26.1 nënpar. c) të RRPP është përcaktuar se një tender mund të dorëzohet nga një Grup i Operatorëve Ekonomik me ç'rast së bashku me tenderin duhet të dorëzohet edhe: *"Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit"*.

Sipas dispozitës së sipërcituar respektivisht nenit 26 par. 26.1 nënpar. c) të RRPP përcaktohet se anëtarët e grupit të operatorëve ekonomik duhet të nënshkruajnë një deklaratë përmes të cilës "autorizohet partneri udhëheqës për të vepruar në emër të grupit". Pra operatori ekonomik që është udhëheqës (lider) do të autorizohet edhe për të vepruar në emër të grupit. Ndërsa te GOE parashtrues njëri anëtar është caktuar si bartës dhe tjetri si përfaqësues që nënkupton se është shkelur neni 26 par. 26.1 nënpar. c) i RRPP.



MARREVESHJE

Mbi Themelimin e Grupit – KONSORCIUMIT

E përpiluar në Tiranë, më datën 1 Qershor 2023 ndërmjet paleve:

1. Shoqëria "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k., - person juridik shqiptar i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar me numer identifikues K61814023M me adrese në Njesia Bashkiake nr. 5, Rrug Sami Frashëri, 50 m mbi shkollën Petro Nini Luarasi, Pallati Bjorn, Kati II, Tiranë, përfaqësuar ligjrisht nga Administratori Olset Haxhiu.
2. Shoqëria "GeO – Group" sh.p.k., - person juridik Kosovar i regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të bizneseve në Kosovë me numer identifikues 810842353 me adrese në Arberia III Veranda C2, 10 Ob, D3 K.II Nr.14, Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar ligjrisht nga Kushtrim Krasniqi.

Me anën e kësaj marreveshje pale të kontraktuese deklarojnë si vijon:

Kompanitë "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k., dhe "GeO – Group" sh.p.k., me anë të kësaj marreveshje deklarojnë themelimin e Grupit – Konsorciumit, me qëllim të ofitimit të përbashkët pranë Kuvendi i Komunes së Prishtinës projektin me titull: "HARTIMI I PROJEKTEVE PER NDERTIM TE ULET" me Numer Prokurimit: 616-23-4727-2-1-1.

Pale të kontraktuese pajtohen që të bashkojnë potencialet dhe resurset e përbashkëta njerezore dhe materiale në funksion të themelimit të grupit – Konsorciumit për konkurrimin e përbashkët në tenderin e publikuar nga Kuvendi i Komunes së Prishtinës.

Pale të kontraktuese pajtohen që përfaqësimi pranë Kuvendi i Komunes së Prishtinës të bëhet sipas hierarkisë vijuese:

Shoqëria "GeO-Group" sh.p.k., prezantohet si Përfaqësuesi, Operatori Ekonomik Kontaktues i këtij Grupi – Konsorciumi.

Shoqëria "ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS" sh.p.k., prezantohet si Lider/Bartesi i këtij grupi – konsorciumi.

Grupi i operatorëve ekonomik tenderues ka dorëzuar dokumentet si në vijim:

1. Marrëveshje mbi themelimin e grupit – konsorciumit;
2. Autorizim;
3. Deklaratë mbi përgjegjësitë e veçanta dhe të përbashkëta të grupit – konsorciumit; dhe
4. Deklaratë mbi përgjegjësitë e veçanta dhe të përbashkëta të grupit – konsorciumit.

Përmes nenit 26 par. 26.1 të RRPP dokumentet që kërkohen të dorëzohen në rastet kur tenderues është një grup i operatorëve ekonomik janë si vijon:

"26.1 Një tender mund të dorëzohet nga një grup i Operatorëve ekonomik. Në këtë rast grupi, me tenderin e tyre, duhet të:

- a. Dorëzon një deklaratë të qartë që të gjithë anëtarët e grupit janë së bashku dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e tenderit të grupit, dhe në rast se grupit i jepet kontrata, për performancën e kontratës;*
- b. Dorëzon një deklaratë të nënshkruar nga secili nga anëtarët, që konfirmon pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se nuk janë duke marrë pjesë individualisht dhe/ose në grupe tjera në procedurën e njëjtë të prokurimit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm);*
- c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm".*

Nëse krahasohen dokumentet me të cilat ka ofertuar parashtruesi me dokumentet që janë kërkuar sipas nenit 26 par. 26.1 të RRPP, mund të vërehet se këto dokumente nuk përputhen as për nga lloji apo nga forma mirëpo as për nga përmbajtja e kërkuar. Pra nuk janë dorëzuar deklaratat e kërkuara sipas dispozitës së cituar më sipër. Për më tepër, në deklaratën e operatorit ekonomik "Illyrian Consulting Engineers" thuhet se i njëjti e lëshon këtë deklaratë në cilësinë e liderit të grupit. Në anën tjetër është bashkangjitur edhe një deklaratë nga "Geo Group" ku thuhet se i njëjti e lëshon këtë deklaratë në cilësinë e partnerit të parë. Ngjashëm edhe në marrëveshjen për themelimin e GOE thuhet se "Illyrian Consulting Engineers" është lider/bartës ndërsa "Geo-Group" është përfaqësues i konsorciumit. Rrjedhimisht nuk është plotësuar si duhet pjesa I pika 3 nënkriteret 1 dhe 2 të RRPP të Dosjes së Tenderit në kuptim të nenit 26 të RRPP lidhur me nenin 71 të LPP. Prandaj duke marrë parasysh pikën 10 të UPP plotësimi i saktë i formularit të tenderit është kusht administrativ i cili në rast se nuk përmbushet, oferta refuzohet menjëherë si e papërgjegjshme pa nevojën që të kërkohen sqarime shtesë.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Geo Group Sh.P.K." janë të pabazuara ndërsa kërkesa për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar.

5. **Pretendimet e OE "Arhiko.Ing Sh.P.K." janë se të gjitha dokumentet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar janë nënshkruar nga personi i paaautorizuar (Veton Jahaj) i cili sipas dokumenteve të biznesit nuk është në asnjë pozitë drejtuese të kompanisë. Po ashtu pretendon se në disa dokumente të tenderuesit të rekomanduar ka pasur falsifikim të nënshkrimit. Pastaj pretendohet se nuk është vlerësuar si duhet sqarimi mbi tenderin jonormalisht të ulët nga tenderuesi i rekomanduar. Njëkohësisht pretendohet se tenderuesi tjetër i shpallur si i përgjegjshëm "Infra Plus" nuk ka dorëzuar vendimet për nostrimikimin e diplomave për inxhinierin e gjeodezisë Jetmir Avdija si dhe për inxhinierin e infrastrukturës Erjon Isaku.**

Lidhur me pretendimet për falsifikim të nënshkrimit nga tenderuesi i rekomanduar "Florije Jahaj" si dhe për vendimet për nostrifikim nga tenderuesi "Infra Plus", komisioni për rivlerësim mund të kërkoj sqarime shtesë në kuptim të nenit 72 të LPP nëse një veprim i tillë do të jetë i nevojshëm. Përndryshe sa i përket pretendimeve për falsifikim të nënshkrimit, parashtruesi mund t'i drejtohet edhe organeve kompetente për hetimin e veprave penale në Republikën e Kosovës, nëse konsideron se për një veprim të tillë ekziston dyshim i arsyeshëm sipas legjislacionit në fuqi. Sa i përket pretendimeve lidhur me nënshkrimin e dokumenteve nga personi i paaautorizuar, duhet cekur se në dokumentet e biznesit të tenderuesit të rekomanduar për kontratë z. Veton Jahaj nuk evidentohet si pronar aksionar apo drejtor menaxhues apo përfaqësues i autorizuar sipas ligjit. Ndërsa lidhur me pretendimet se nuk është vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë sqarimi i tenderuesit të rekomanduar për tender jonormalisht të ulët, fillimisht duhet sqaruar se për parashtruesin nuk është fare kontestues fakti se autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime nga tenderuesi i rekomanduar përmes letrës standarde për tenderët jonormalisht të ulët. Për parashtruesin mbetet kontestues vetëm fakti nëse vlerësimi i sqarimeve që ka ofruar tenderuesi i rekomanduar është bërë në përputhje me nenin 41 paragrafët 41.8 dhe 41.9 lidhur me paragrafin 41.10 të RRPP.

Tenderuesi i rekomanduar me datë 30.01.2024 ka dërguar sqarimet shtesë për tenderin jonormalisht të ulët mirëpo në raportin e vlerësimit nuk evidentohet askund se në cilën formë dhe mbi bazën e cilave kriterë komisioni vlerësues ka përcaktuar tenderin jonormaisht të ulët sipas sqarimeve të ofruara nga tenderuesi i rekomanduar. Duke marrë parasysh këtë fakt duke cekur se përmes nenit 41 par. 41.10 të RRPP është përcaktuar se *"Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose: a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; ose b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulët, brenda dy dite nga data e vendimit"*. Ndërsa përmes nenit 41 par. 41.8 RRPP është përcaktuar se *"Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara"*. Tutje përmes nenit 41 par. 41.9 thuhet se *"Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet"*.

Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore të OE "Arhiko.Ing Sh.P.K." janë të bazuara pjesërisht ndërsa kërkesa për rishqyrtim është miratuar pjesërisht.

Duke marrë parasysh arsyetimin si më sipër është vendosur që të anulohet Njoftimi mbi Vendimin i datës 01.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit është kthyer në rivlerësim.

Për pikat I deri V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. të RRPP. Për pikat VI deri VIII të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. dhe 63.3. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.03.2024



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.